

RELACION

LIDHUR ME TRAJTIMIN E PROBLEMATIKAVE TË NGRITURA NË SHKRESËN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Në lidhje me shkresën e ardhur nga Institucioni i Presidentit të Republikës

Më datë 15.04.2020, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ka mbërritur shkresa me nr. 1117/2 prot., datë 10.04.2020 e Presidentit të Republikës, me lëndë “Mbi ndërprerjen e qëndrimit të mëtejshëm në detyrë të z. Ardian Dvorani si anëtar i Gjykatës së Lartë dhe kryesimin në vijim të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.” Kjo shkresë i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtarëve në detyrë në Gjykatën e Lartë dhe i është dërguar për dijeni Kuvendit të Shqipërisë, anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe institucionit të Avokatit të Popullit.

Nëpërmjet kësaj shkrese, Presidenti i Republikës, ka adresuar problematikën, që në vlerësimin e tij është krijuar nga vazhdimi i qëndrimit në detyrë të z. Ardian Dvorani, si anëtar i Gjykatës së Lartë dhe Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në shkresën e tij, Presidenti i Republikës, vlerëson se adresimi i problematikës lidhur me mandatin dhe vazhdimin e qëndrimit në detyrë të z. Dvorani, ka rëndësi thelbësore për të siguruar organizimin, funksionimin e plotë dhe të qartë të Gjykatës së Lartë, me qëllim që në këtë fazë të ripërtëritjes së saj të mos lihet asnjë mundësi, që jo vetëm funksionimi i saj, por edhe korrektësia e proceseve gjyqësore, të mos çënohen dhe të mos shfaqin defekte të rënda në kuptim të procesit të rregullt ligjor, që mund të sjellë pasoja të rënda e të parikuperueshme për to në të ardhmen, që vijnë përmes shqyrtimit të ankimeve në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në këtë shkresë, Presidenti i Republikës vlerëson se në kushtet:

- kur z. Dvorani, i ka mbaruar mandati si gjyqtar në Gjykatën e Lartë që në shkurt të vitit 2014;
- kur neni 136, paragrafi 5 i Kushtetutës përcakton se *gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit*; kur në shkresën e Këshillit të Lartë Gjyqësor citohet se “[...] në shpalljen e 3 (tre) pozicioneve të lira, përmes vendimeve nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konsideruar numrin e pozicioneve që kanë të lira në të moment [...], dhe kur pozicioni i z. Ardian Dvorani ka qenë i lirë;
- kur pozicioni i katërt vakant që po shqyrtohet nga KLGJ-ja, duhet të plotësohet nga radhët e juristëve të spikatur (jo gjyqtarë) dhe siç është deklaruar nga KLGJ-ja, i përket plotësimit të vendit vakant të krijuar nga përfundimi para kohe i mandatit të ish-gjyqtarit z. Xhezair Zaganjori;
- kur tashmë Gjykata e Lartë ka në përbërje të saj 3 gjyqtarë të rinj të emëruar në detyrë, që kanë filluar ushtrimin e detyrës

sipas dispozitave të sipërcituara të Kushtetutës dhe ligjit, me emërimin dhe fillimin e ushtrimit të mandatit të rregullt të anëtarit të parë në Gjykatën e Lartë, që përkon me fillimin e ushtrimit të mandatit të z. Sokol Sadushaj, zotit Ardian Dvorani i ka përfunduar tashmë dhe “detyrimi” për vijimin e ushtrimit të detyrës, detyrim ky që sipas tij, e ka mbajtur atë të lidhur me pozicionin si anëtar i Gjykatës së Lartë për thujse 7 vjet pas përfundimit të mandatit të rregullt.

Me anë të kësaj shkrese, Presidenti i Republikës, vlerëson të sjellë në vëmendje të Këshillit të Lartë Gjyqësor se, kur mbarimi i mandatit të zotit Dvorani si gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe deklarimi i këtij fakti ka ndodhur në periudhën janar-shkurt 2014, ***në funksion të transparencës, lind nevoja e bërjes publike të ndërprerjes së qëndrimit në detyrë të z. Ardian Dvorani***, të cilit i ka humbur çdo lloj e drejte apo justifikimi për të vijuar funksionin edhe si kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi përgjatë pjesës së mbetur të vitit 2020.

Trajtimi i shkresës me nr. 1117/2 prot, datë 10.04.2020 të ardhur nga Presidenti i Republikës

Pas evidentimit të faktit të ardhjes së kësaj shkrese pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, ky Këshill, në mbledhjen e datës 16.04.2020, vendosi të përfshijë në rendin e ditës të kësaj mbledhje, për diskutim, shkresën e Presidentit të Republikës e në vijim vendosi të ngarkojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës për paraqitjen e një relacioni të detajuar lidhur me këtë çështje me qëllim dhënien e mundësisë Këshillit për të vlerësuar pozicionin e tij dhe reagimin eventual lidhur me këtë shkresë dhe problematikën e adresuar në të.

Me qëllim arritjen e një vlerësimi sa më të drejtë nga ana e Këshillit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, çmon të rëndësishme të parashtrorë të gjithë procedurat e ndjekura deri më sot nga Këshilli i Lartë Gjyqësor lidhur me ngritjen dhe vënien në funksionim të Gjykatës së Lartë si dhe rrethanat e faktit dhe të ligjit që lidhen me situatën e gjyqtarit, z. Ardian Dvorani.

Procedurat e ndjekura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor lidhur me ngritjen dhe vënien në funksionim të Gjykatës së Lartë

Aktualisht, numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë është 19 (nëntëmbëdhjetë). Ky numër është përcaktuar me Ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 151/2013 (neni 1). Pavarësisht shfuqizimit të këtij ligji (me Ligjin Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”), numri i përgjithshëm i gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë i përcaktuar nëpërmjet tij mbetet ende ligjërisht në fuqi në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk ka marrë një vendim për numrin e gjyqtarëve për çdo gjykatë, të përcaktuar sipas kërkesave të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, sikurse një gjë e tillë përcaktohet në dispozitën kalimtare të këtij të fundit, pikërisht nenin 90, sipas të cilit: ***“Derisa të merret një vendim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për numrin e gjyqtarëve për gjykatë, në përputhje me këtë ligj, numri i gjyqtarëve për gjykatë mbetet siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi”***.

Vlen të përmendet se përcaktimi, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, i numrit të gjyqtarëve për çdo gjykatë, në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në

Republikën e Shqipërisë”, është i kushtëzuar nga miratimi i hartës së re gjyqësore, proces për të cilin Këshilli është në fazën e fundit të përgatitjes së propozimit, i cili duhet të dakortësohet me Ministrinë e Drejtësisë, për t’iu përcjellë nga ky i fundit për miratim Këshillit të Ministrave, sikurse përcaktohet në nenin 13 të ligjit në fjalë. Ky proces kushtëzon përcaktimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve, i cili edhe ky, sipas nenit 21 të ligjit, inicohet me propozim të Këshillit bashkë me propozimin për buxhetin e sistemit gjyqësor, sipas procedurës së përcaktuar në këtë dispozitë ligjore.

Në konsideratë të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pra 19 (nëntëmbëdhjetë), duke mbajtur parasysh përcaktimin e nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, por edhe atë të nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilëve, **një e pesta e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë përzgjidhet mes juristëve të spikator, në rastin e hapjes së procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikator (jogjyqtarët), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur që numri i pozicioneve të lira që mund të plotësohen përmes ngritjes në detyrë të jogjyqtarëve, është 4 (katër).**

Vendimmarrjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për hapjes së procedurave për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikator (jogjyqtarët), janë si më poshtë:

1. Vendimi nr.108, datë 09.07.2019, “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikator”¹;
2. Vendimi nr.109, datë 09.07.2019, “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikator”²;
3. Vendimi nr.110, datë 09.07.2019, “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikator”³;
4. Vendimi nr.172, datë 11.09.2019, “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikator”⁴.

Për efekt të procesit të shpalljes së procedurave të emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikator, është vlerësuar e nevojshme marrja nga Gjykata e Lartë të një informacioni në lidhje me mandatet e 19 (nëntëmbëdhjetë) gjyqtarëve të saj, të emëruar në periudhën e fundit. Nëpërmjet këtij informacioni do të mund të merreshin të dhëna për aktet e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, radhët nga të cilat ata ishin emëruar (gjyqtarëve ose jogjyqtarëve), si dhe për përfundimin e mandatit të tyre.

Nga informacioni i marrë nga Gjykata e Lartë⁵, është konstatuar se:

¹ Për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës administrative.

² Për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile.

³ Për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës penale.

⁴ Për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile.

⁵ Shkresa nr.1926/1 prot., date 08.07.2019.

1. Z. Xhezair Zaganjori - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.22.03.2013, dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 5, datë 01.04.2013. Ai është emëruar nga *radhët e jogjyqtarëve*. Nuk i ka mbaruar mandati.
2. Z. Ardian Dvorani - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.4481, datë 17.02.2005 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 175, datë 24.02.2005. Ai është emëruar nga *radhët e jogjyqtarëve*. Mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar, por vijon ushtrimin e detyrës deri në zëvendësimin nga një anëtar tjetër. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.
3. Z. Medi Bici - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.6579, datë 25.05.2010 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 42, datë 08.07.2010. Ai është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i tij 9-vjeçar është pezulluar, për shkak të zgjedhjes së tij si anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një periudhë 3-vjeçare.
4. Znj. Majlinda Andrea - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5795, datë 08.07.2008 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 210, datë 28.07.2008. Ajo është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i saj ka mbaruar ndërsa është deklaruar fajtores për veprën penale të “korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, me Vendim nr.25, datë 14.06.2017, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me të cilin është caktuar dhe dënimi plotësues “heqja e të drejtës për të kryer funksione publike” për një afat prej 5 vjetësh. Pozicioni i saj është i lirë.
5. Z. Ardian Nuni - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5252, datë 04.04.2007 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 106, datë 04.06.2007. Ai është emëruar nga *radhët e jogjyqtarëve*. Mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar me Vendim të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 21.04.2016. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.
6. Znj. Mirela Fana - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.6133, datë 14.04.2009 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 248, datë 23.04.2009. Ajo është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i saj 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të dorëheqjes, me Vendim të Gjykatës së Lartë nr.1, datë 31.01.2017. Pozicioni i saj konsiderohet i lirë.
7. Znj. Arjana Fullani - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5791, datë 8.7.2008 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi me Vendimin nr. 206, datë 28.07.2008. Ajo është emëruar nga *radhët e jogjyqtarëve*. Mandati i saj 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, bazuar në kërkesën e saj, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendim nr. 4, datë 29.06.2017. Me Vendimin nr.67, datë 24.04.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka deklaruar mbarimin e statusit të magistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lire në gjykatë apeli. Pozicioni i saj konsiderohet i lirë.

8. Znj. Evelina Qirjako - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5793, datë 8.7.2008 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 208, datë 28.07.2008. Ajo është emëruar nga *radhët e jogjyqtarëve*. Mandati i saj 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, bazuar në kërkesën e saj, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendim nr. 6, datë 29.06.2017. Me Vendimin nr.66, datë 24.04.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lire në gjykatë apeli. Pozicioni i saj konsiderohet i lirë.
9. Z. Guxim Zenelaj - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5794, datë 8.7.2008 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 209, datë 28.07.2008. Ai është emëruar nga *radhët e jogjyqtarëve*. Mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, bazuar në kërkesën e tij, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendim nr. 3, datë 29.06.2017. Me Vendimin nr.65, datë 24.04.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lire në gjykatë apeli. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.
10. Z. Andi Çeliku - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5792, datë 8.7.2008 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 207, datë 28.07.2008. Ai është emëruar nga *radhët e jogjyqtarëve*. Mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, bazuar në kërkesën e tij, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendim nr. 5, datë 29.06.2017. Me Vendimin nr.64, datë 24.04.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lire në gjykatë apeli. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.
11. Z. Aleksandër Muskaj - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.5790, datë 8.7.2008 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 205, datë 28.07.2008. Ai është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i tij 9-vjeçar ka mbaruar, për shkak të deklarimit të mbarimit të mandatit, bazuar në kërkesën e tij, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me Vendim nr. 2, datë 29.06.2017. Me Vendimin nr.63, datë 24.04.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të heqjes dorë nga e drejta e caktimit në një pozicion të lire në gjykatë apeli. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.
12. Z. Shkëlzen Selimi - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.6684, datë 16.09.2010 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi me Vendimin nr. 104, datë 16.06.2011. Ai është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr.3, datë 07.02.2019. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.
13. Z. Admir Thanza - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.8115, datë 19.04.2013 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi me Vendimin nr. 22/2013. Ai është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak

të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr.10, datë 18.04.2019. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.

14. Z. Artan Zeneli - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.7250 datë 1.2.2012 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 36/2012. Ai është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr.2, datë 04.02.2019. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.
15. Z. Tom Ndreca - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.8116, datë 19.04.2013 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 23/2012. Ai është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr.11, datë 22.11.2018. Pozicioni i tij konsiderohet i lirë.
16. Z. Edmond Islamaj - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.6682 datë 16.9.2010 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi me Vendimin nr. 102, datë 16.09.2012. Ai është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i tij ka mbaruar, për shkak të shkarkimit të tij nga detyra me Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr.11, datë 22.05.2019. Pozicioni i tij konsiderohet pozicion i lirë.
17. Z. Artan Broci - është emëruar në Gjykatën e Lartë, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.8123 datë 26.4.2013 dhe dhënien e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr. 27/2013. Ai është emëruar nga *radhët e gjyqtarëve*. Mandati i tij është pezulluar për shkak se Komisionit i Pavarur i Kualifikimit ka marrë vendim për shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit, ndërkohë që ai ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Pozicioni i tij nuk konsiderohet i lirë⁶.

Nga informacioni si më lart, në atë rast është konstatuar se Gjykata e Lartë ka patur vetëm 17 (shtatëmbëdhjetë) gjyqtarë, duke mos u plotësuar numri 19 (nëntëmbëdhjetë). Nga 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarët e fundit të Gjykatës së Lartë, 7 (shtatë) prej tyre kishin ardhur nga radhët e jogjyqtarëve dhe 10 (dhjetë) anëtarë nga radhët e gjyqtarëve. Nga 7 (shtatë) anëtarët e ardhur nga radhët e jogjyqtarëve, vetëm dy prej tyre, z.Xhezair Zaganjori dhe z.Ardian Dvorani, vijonin ushtrimin e detyrës të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Për z.Xhezair Zaganjori mandati mbaronte në vitin 2021. Ndërkohë, për z.Ardian Dvorani mandati kishte mbaruar, por ai qëndronte në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, çka e bënte të lirë pozicionin që ai mbante.

Pra, në momentin e miratimit të Vendimeve nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, në Gjykatën e Lartë, në total, ka patur 6 (gjashtë) pozicione të lira, të cilat me parë ishin plotësuar nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarëve). Nga këto pozicione të lira, vetëm 3 (tre) prej tyre mund të plotësoheshin nga radhët e jogjyqtarëve, sipas përcaktimeve të nenit 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikën e Shqipërisë”, ndërsa pozicioni i katërt konsiderohej i zënë nga ligji, përse kohë ndodhej në detyrë dhe vijonte ushtrimin e mandatit z.Xhezair Zaganjori.

⁶ Mandati i gjyqtarit Artan Broci ka mbaruar më pas, me Vendimin nr.16, datë 18.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Sa i përket Vendimit nr.172, datë 11.09.2019, “Për shpalljen e procedurës së emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur”, Këshilli i Lartë Gjyqësor e mori atë në kushtet kur Kolegji i Posaçëm i Apelit, me Vendimin nr.19, datë 26.07.2019, ndryshoi vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit⁷, duke vendosur shkarkimin nga detyra të z.Xhezair Zaganjori, gjyqtar me detyrë kryetar i Gjykatës së Lartë, vendim ky përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm. Pas largimit nga detyra edhe të gjyqtarit të fundit të Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, Këshilli, në përputhje me detyrimin e tij ligjor, hapi procedurën për plotësimin edhe të pozicionit të katërt dhe të fundit, nga radhët e juristëve të spikatur.

Në lidhje me plotësimin e trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë me 19 (nëntëmbëdhjetë) anëtarë, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përfunduar procedurat për 3 (tre) pozicione të lira, të shpallura për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarëve). Në këto raste, Presidentit të Republikës i janë përcjellë propozimet për emërim për 3 (tre) kandidatë, për secilin nga 3 (tre) pozicionet e lira. Për pozicionin e katërt, të shpallur për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarëve), Këshilli është në shqyrtim e sipër të procesit të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin e fundit, proces pas të cilit, në varësi të rezultateve të tij, vijon kryerja e procedurës së përzgjedhjes për emërim mes kandidatëve të kualifikuar.

Pas propozimeve të bëra nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Presidenti i Republikës, emëroi zotin Sadushaj, zotin Pupe dhe zotin Panda si gjyqtarë të Gjykatës së Lartë. Pas kryerjes së betimit para Presidentit në datën 13 mars 2020, tre gjyqtarët e rinj kanë nisur punën zyrtarisht.

Sa i përket plotësimit trupës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor plotësoi kuadrin ligjor nëpërmjet të cilit do të mundësohej realizimi i procedurave të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, përfshirë edhe në Gjykatën e Lartë dhe në mbledhjen e datës 26 shkurt 2020, nëpërmjet vendimeve respektive⁸, Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për 6 (gjashtë) pozicione të lira, 3 (tre) në fushën e të drejtës administrative dhe 3 (tre) në fushën e të drejtës civile.

Lidhur me vendet vakante që i korrespondojnë 3 (tre) kandidaturave të propozuara për emërim, tashmë të emëruar nga Presidenti i Republikës. Në shpalljen e 3 (tre) pozicioneve të lira, përmes Vendimeve nr. 108, nr. 109 dhe nr. 110, datë 09.07.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka konsideruar numrin e pozicioneve që kanë qenë të lira në atë moment dhe që mund të plotësoheshin nga radhët e juristëve të spikatur (jogjyqtarëve), duke konsideruar se 3 (tre) pozicionet e lira të shpallura nuk janë të lidhura nominalisht me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, nga radhët e juristëve të spikatur, të cilëve iu kishte mbaruar mandati dhe nuk kanë vijuar ushtrimin e detyrës. Kushtetuta dhe ligji nuk parashikojnë zëvendësimin strikt të vendit vakant të lënë nga gjyqtari i larguar i Gjykatës së Lartë, sikundër as të viteve që atij mund t'i kenë mbetur. Në çdo rast, gjyqtari i Gjykatës së Lartë në momentin e emërimit/zgjedhjes së tij merr një mandat të plotë 9 vjeçar, duke mos qenë i rëndësishëm specifikimi i vendit të gjyqtarit që zëvendëson. Përveç kësaj, siç dhe u përmend, në periudhën e fundit, në Gjykatën e Lartë kanë ushtruar detyrën 7 (shtatë) gjyqtarë, të ardhur nga radhët e juristëve të spikatur, ku në momentin e shpalljes së 3 (tre) pozicioneve të lira,

⁷ Vendimi nr. 46, datë 24.07.2018,

⁸ Vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, nr. 85, nr. 86 dhe nr. 87, datë 26.02.2020.

për 6 (gjashtë) nga ata kishte mbaruar mandati. Pra, edhe praktikisht, 3 (tre) pozicionet e lira të shpallura nuk mund të lidheshin nominalisht me 6 (gjashtë) gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që iu kishte mbaruar mandati, 5 (pesë) nga të cilët nuk kanë vijuar ushtrimin e detyrës pas këtij momenti. Për rrjedhojë, 3 (tre) kandidaturat e propozuara për emërim e tashmë të emëruar nga Presidenti i Republikës, nuk i korrespondojnë ndonjë pozicioni të lirë që lidhet nominalisht me 6 (gjashtë) gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilëve iu kishte mbaruar mandati para datës 09.07.2019, të hapjes së procedurave të emërimit, nga radhët e juristëve të spikatur.

Në lidhje me mandatin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, z. Dvorani dhe vijimin e ushtrimit të detyrës nga ana e tij

Gjyqtari Ardian Dvorani është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë me dekretin e Presidentit të Republikës nr.4481, datë 17.02.2005.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr.175, datë 24.02.2005, ka dhënë pëlqimin për emërimin e z. Ardian Dvorani në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë, për një periudhë 9 vjeçare, bazuar në nenin 136 të Kushtetutës. Emërimi i z. Dvorani në këtë detyrë ka ardhur nga radhët e jogjyqtarëve.

Në bazë të pikës 1 të nenit 136 të Kushtetutës, Kryetari dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë qëndronin në detyrë për 9 vjet pa të drejtë riemërimi. Mbi këtë bazë mandati i tij duhet të përfundonte më datë 24.02.2014.

Sipas nenit 4 të ligjit të kohës, nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kryetari i Gjykatës së Lartë, përmes shkresës me nr.prot.39, datë 16.01.2014, administruar në Institucionin e Presidentit të Republikës me shkresën me nr. Prot.89, datë 17.01.2014, ka njoftuar mbi përfundimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, zotit Ardian Dvorani.

Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 8515, datë 10 mars 2014 ka emëruar si anëtar të Gjykatës së Lartë zotin Alaudin Malaj. Ky dekret nuk mori pëlqimin e Kuvendit, i cili me vendimin nr.35, datë 22.05.2014, ka vendosur mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Alaudin Malaj si anëtar i Gjykatës së Lartë.

Sipas ligjit organik që ishte në fuqi për Gjykatën e Lartë, pika 3 e nenit 5 të tij (*nen i ndryshuar me ligjin nr.151/2013*), gjyqtari të cilit i ka përfunduar apo i ka mbaruar mandati, vazhdon të ushtrojë detyrën deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, gjyqtari Ardian Dvorani vazhdoi ushtrimin rregullisht të detyrës edhe pas mbarimit të mandatit më datë 24.02.2014.

Një grup deputetësh, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për të shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën paragrafin 3 të nenit 5 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), i cili kishte të bënte me vazhdimin e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit që i ka mbaruar mandati, deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës.

Gjykata Kushtetuese, zhvilloi seancën më datën 3 maj 2016. Më datë 27 qershor 2016, ajo bëri zyrtarisht njoftimin në faqen e saj zyrtare, duke theksuar se ka pranuar kërkesën e grupit të deputetëve, duke e gjetur si të papajtueshëm me Kushtetutën paragrafin 3 të nenit 5 të ligjit nr.8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Nga data 28 qershor 2016, gjyqtari Ardian Dvorani nuk mori pjesë në gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë.

Më datë 27 korrik 2016, vendimi i arsyetuar i Gjykatës Kushtetuese me nr.55, datë 27.07.2016, u është dërguar palëve pjesëmarrëse në proces, konkretisht kërkesit (një grup prej 35 deputetësh), si dhe subjekteve të interesuara (Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave). Ky vendim u botua në Fletoren Zyrtare nr.152, datë 12 gusht 2016.

Situata ligjore ndryshoi me miratimin e ligjit nr.76, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), ligj i cili u botua në Fletoren Zyrtare nr.138, datë 27 korrik 2016.

Në pikën 5 të nenit 136 të Kushtetutës u parashikua se: “Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”.

Ky ligj kushtetues hynte në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare (botimi u bë në datë 27 korrik 2016). Konkretisht kjo do të thotë se ai ka hyrë në fuqi më datë 10 gusht 2016, pra 2 ditë para hyrjes në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që deklaronte si të papajtueshëm me Kushtetutën paragrafin 3 të nenit 5 të ligjit organik të Gjykatës së Lartë që lejonte vazhdimin e detyrës së anëtarit të Gjykatës së Lartë edhe pas mbarimit të mandatit.

Me qëllim sqarimin e situatës së tij ligjore, gjyqtari Ardian Dvorani, referuar informacionit të ardhur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr.627 prot, datë 10.03.2020, ka kërkuar verbalisht thirrjen e Trupës Gjyqësore të Gjykatës së Lartë, e cila u mbledh në mënyrë informale më datë 12.10.2016 dhe pas diskutimeve arriti unanimisht në përfundimin se nuk ka lëndë për të cilën ajo duhet të prononcohet. Në mbledhje, referuar shkresës, është theksuar se Kryetari i Gjykatës së Lartë i ka zbatuar dispozitat ligjore në fuqi dhe ka bërë njoftimin për përfundimin e mandatit të gjyqtarit Ardian Dvorani që më datë 16 janar 2014.

Që prej datës 18 tetor 2016, gjyqtari Ardian Dvorani ka rifilluar me gjykimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, duke vlerësuar se mund të qëndrojë në detyrë deri në emërimin e gjyqtarit pasardhës.

Vlerësimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës

Lidhur me kompetencën e Këshillit të Lartë Gjyqësor për trajtimin e kësaj çështjeje dhe kufijtë e shqyrtimit të saj, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në konsideratë të nenit 61 të ligjit

nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, vlerëson se problematika e adresuar në shkresën e Presidentit të Republikës nuk lidhet me ndonjë nga kompetencat që Këshilli ushtron në mbledhje plenare apo me ndonjë vendimmarrje të caktuar të Këshillit.

Në interpretim të nenit 61 të ligjit të sipërcituar, në lidhje dhe në raport dhe me dispozitat e tjera të këtij ligji dhe të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor në raport me Gjykatën e Lartë lidhen me kompetencën e Këshillit për t’i propozuar Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë; vlerësimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë; vendosjen e masave disiplinore ndaj tyre; shqyrtimin e kërkesës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë të cilit i mbaron mandati për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli; deklarimin e mbarimit të statusit të magistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, në rastet e përcaktuara specifikisht nga ligji.

Në rastin konkret, nuk ndodhemi para asnjë prej situatave ligjore të sipërpërmendura. Në rastin konkret, ashtu siç citohet në shkresën e Presidentit, por dhe siç është konstatuar nga Këshilli, jemi para faktit të mbarimit të mandatit të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë dhe vijimit të ushtrimit të detyrës nga ana e tij “*deri në emërimin e pasardhësit*”.

Ashtu siç u citua dhe më sipër, mandati i gjyqtarit Ardian Dvorani ka përfunduar më datë 24.02.2014 dhe në përputhje me ligjin e asaj kohe, konkretisht bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përfundimi i këtij mandati i është njoftuar Presidentit të Republikës, në kushtet kur ky ligj nuk përcaktonte ndonjë vendim deklarativ të Gjykatës së Lartë apo të ndonjë institucioni tjetër lidhur me deklarimin e përfundimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Pas përfundimit të mandatit të tij, gjyqtari Dvorani ka vijuar të ushtrojë detyrën pranë Gjykatës së Lartë në pritje të emërimit të pasardhësit të tij, si një detyrim i sanksionuar shprehimisht si në ligjin nr. 8588, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe më pas në nenin 136 (5) të Kushtetutës, pas ndryshimeve që solli ligji nr. 76, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

Në analizë të rrethanave të parashtruara dhe të kornizës kushtetuese dhe ligjore që rregullon mandatin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, kohëzgjatjen e qëndrimit të tij në detyrë, mënyrën e konstatimit të përfundimit të mandatit të tij, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vlerëson se ligji nuk i ka akorduar Këshillit ndonjë rol të caktuar në momentin e përfundimit të mandatit të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë, as rol vendimmarrës dhe as rol deklarativ. Bazuar në pikën 6 të nenit 64 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë jo më vonë se dy javë nga fundi i muajit përkatës, ndërsa sipas ligjit nr.8558, datë 15.03.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, përfundimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, i njoftohet Presidentit të Republikës nga kryetari i Gjykatës së Lartë.

Në rastin e zotit Dvorani, Komisioni vlerëson se mandati i tij si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, ka përfunduar ligjërisht në vitin 2014 dhe lidhur me përfundimin e këtij mandati është njoftuar Presidenti i Republikës sipas ligjit të kohës që ka rregulluar këtë marrëdhënie institucionale, konkretisht sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8558, datë 15.03.2000. Pas këtij momenti e deri më sot, zoti Dvorani ka vijuar të ushtrojë detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, në pritje të emërimit të pasardhësit të tij. Në kushtet kur tashmë në Gjykatën e Lartë janë emëruar dhe ushtrojnë funksionin

tre gjyqtarë, në kushtet kur asnjëri prej tyre nuk zëvendëson nominalisht zotin Dvorani apo anëtarët e tjerë mandati i të cilëve ka përfunduar, por potencialisht secili prej tyre mund të zëvendësojë çdo mandat të mëparshëm, Komisioni vlerëson se i përket Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kushtetues i ngarkuar për të *siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*, të vlerësojë dhe të vendosë nëse duhet të mbajë një qëndrim lidhur me ligjshmërinë e vijimit të ushtrimit të detyrës nga ana e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, mandati i të cilit ka mbaruar si dhe të vlerësojë nëse me emërimin e tre gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë, zotit Dvorani i ka mbaruar detyrimi kushtetues i qëndrimit në detyrë deri në emërimin e pasardhësit.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se çështjet objekt diskutimi nga Këshilli janë:

1. *A i ka mbaruar zotit Dvorani detyrimi për të qëndruar në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë deri në emërimin e pasardhësit?*
2. *Në hipotezën që ky detyrim i ka mbaruar, në situatën që zoti Dvorani vijon të qëndrojë në detyrë, a është Këshilli autoriteti që ka kompetencën për zgjidhjen e këtij ngërçi?*
3. *Nëse po, cila është mënyra e veprimit të Këshillit?*
4. *A mund të jetë një vendimmarrje një mënyrë veprimi nga Këshilli?*
5. *Nëse po, cila vendimmarrje e Këshillit i përgjigjet situatës konkrete?*
6. *Nëse jo, cila mund të jetë forma e veprimit nga Këshilli?*

Komisioni vlerëson se pas trajtimit të të gjitha këtyre çështjeve dhe problematikave, Këshilli do të mund të konkludojë përfundimisht lidhur me situatën që paraqitet.

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS